



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program

Studime Albanologjike (2023/2024)

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	120
Kodi	N-MALBST120C
Titulli	Magjistër i Studimeve Albanologjike
Numri në arkiv i akreditimit [120]	03-2770/1
Numri në arkiv i akreditimit []	
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	17.08.2023

Përshkrimi i programit

Programi pasdiplomik për *studime albanologjike* është dizajnuar me qëllim që studentët të cilët do të përfshihen në këtë program të fitojnë njohuri që i afrojnë kah profesionet të cilat janë të lidhura ngushtë me sferën e gjuhës, kulturës, letërsisë dhe arsimit. Njëherësh studentët fitojnë shkathtësi dhe kompetenca për punësim në nivele më të larta të sektorit publik dhe privat.

Karriera

Studentët e diplomuar do të mund të punësohen në fusha të shumta të jetës shoqërore dhe profesionale:

Mësimdhënie: në shkolla të gjuhës, në gjimnaze, në shkolla fillore dhe të mesme, profesorë universitarë.

Punësim: gjuhëtarë, gazetarë, në ndërmarrje të ndryshme si lektorë, përkthyes dhe interpretues të gjuhës shqipe në ministri dhe institucione të tjera qeveritare, përkthyes/interpretues në gjyqe dhe institucione të tjera të ngjashme, përkthyes/interpretues në organizatat profesionale, përkthyes/interpretues në sektorin shoqëror dhe atë privat, përkthyes/interpretues në organizata ndërkombëtare

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Me këtë program kandidati fiton njohuri të përgjithshme për shumë fusha gjuhësore dhe letrare, si ato njëdisiplinare ashtu edhe në ato interdisiplinare. Me këto ai fiton njohuri më të reja dhe të rëndësishme bashkëkohore, që do t'i mundësojë të jetë më kreativ dhe më profesional në zgjidhjen e problemeve gjuhësore dhe letrare.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Korpusi i njohurive i mundëson studentit punësime të ndryshme që përfshijnë sektorë të shumtë dhe të llojllojshëm të jetës shoqërore dhe profesionale. Njohuritë mund të zbatohen në mësimdhënieduke punuar si profesor në shkollat e mesme dhe si asistent në fakultetet dhe institutet përkatëse; studenti mund të punojë si studiues dhe hulumtues nga fusha e gjuhësisë dhe e folklorit në institutet e ndryshme albanologjike; mund të punojë si gazetar, redaktor dhe lektor, por edhe si kritik gjuhësor në media të ndryshme elektronike dhe të shkruara, ku mund të ***japë kontribut për çështjen e zbatimit të normës letrare***; mund të punojë si përkthyes dhe interpretues i gjuhës shqipe në komunat dygjuhësore, nëpër ministri dhe në institucionet tjera qeveritare, në gjyqe dhe institucione tjera të ngjashme, në organizatat profesionale, në sektorin shoqëror dhe atë privat, në organizata ndërkombëtare etj.

Aftësitë për të vlerësuar

Është i aftë të hartojë dhe të vlerësojë plan-programe mësimore nga fusha e gjuhësisë për shkollat fillore, të mesme dhe universitare; mund të vlerësojë mbajtjen e orëve mësimore nga fusha e gjuhësisë dhe letërsisë. Ka aftësi të vlerësojë dhe krahasojë përkthimet nga një gjuhë në gjuhë tjetër; mund ta vlerësojë redaktimin dhe lektorimin e teksteve të ndryshme gjuhësore, letrare dhe publicistike, duke vlerësuar shkallën e lartë të lektorimit dhe duke i gjetur gabimet eventuale gjuhësore; mund ta vlerësojë një vepër edhe nga aspekti kompozicional dhe përmbajtjesor, duke veçuar vlerat gjuhësore dhe letrare. Mund të bëhet anëtar në ndonjë juri profesionale nga fusha e gjuhës dhe letërsisë për të vlerësuar studimet më të mira gjuhësore dhe letrare. Ka aftësi të kyçet në ekipe hulumtuese, të hartojë tekste letrare, publicistike fjalorë leksikorë dhe fjalorë tjerë të ndryshëm.

Aftësitë e komunikimit

Ka shkathtësi profesionale për të mbajtur orë mësimore nga letërsia dhe gramatika e gjuhës amtare në përputhshmëri me plan-programet për shkollat fillore, të mesme dhe universitare. Mund të mbajë kurse për mësimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe për të huajt. Mund të përkthejë vepra shkencore, letrare dhe gjuhësore nga gjuhët në kontakt në gjuhën amtare dhe anasjelltas. Mund të marrë pjesë në simpoziume dhe seminare vendore dhe ndërkombëtare dhe me anë të kumtesave mund të paraqesë rezultate origjinale nga hulumtimet që ka bërë për disiplina të ndryshme letrare dhe gjuhësore. Mund të shkruajë recensionet për vepra të botuara nga fusha e letërsisë dhe e gjuhësisë, pastaj edhe recensionet për botimin e studimeve letrare dhe gramatikave siç janë tekstet mësimore. Mund të bëjë hulumtime të pavarura dhe të marrë përgjegjësi për rezultatet e kumtuara. Mund të botojë artikuj shkencorë dhe vepra nga fusha e letërsisë dhe gjuhësisë.

Aftësitë e të mësuarit

Ka aftësi të zgjidhet asistent në institutet albanologjike dhe të ndihmojë në ekspeditat shkencore; mund të paraqitet si udhëheqës në projekte të caktuara nga fusha e letërsisë dhe gjuhësisë dhe të iniciojë ndryshime në institucione të ndryshme. Për të arritur rezultate më të mira mund të prezantojë njohuri të reja, mund t'i trajtojë të tjerët, duke mbajtur kurse në lëmenj të caktuar, si në: drejtshkrim, lektorim të tekstit letrar, përdorim të metodave dhe teknologjive të reja për mësimdhënie etj.; mund të mbajë trajnime lidhur me përgatitjen e një projekti, shkrimin e një punimi shkencor etj.; mund të propozojë risi për t'i plotësuar mangësitë e institucionit përkatës, siç janë: hapja e seksioneve të ndryshme nga letërsia dhe gjuha, hapja e bibliotekës, promovimi i ndonjë veprë letrare dhe gjuhësore etj.; mund të propozojë metoda të reja për mësimin e shqipes sipas niveleve, për të huajt. Gjithsesi, duhet ta vazhdojë arsimimin e mëtejshëm dhe të pajiset me njohuri të reja, të cilat t'i prezantojë përsëri në institucionin ku punon, por edhe jashtë tij.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [AS0103] [6.0 SETK] **Civilizimi shqiptar**
- [AS0107] [6.0 SETK] **Etnolinguistika**
- [AS0102] [6.0 SETK] **Dimensioni ballkanik i folklorit shqiptar**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**

Semestri 2

- [AS0108] [6.0 SETK] **Fonetika eksperimentale**
- [AS0106] [6.0 SETK] **Analiza e tekstit letrar**
- [AS0105] [6.0 SETK] **Letërsia moderne shqipe**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**

- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**

Semestri 3

- [AS0101] [6.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [AS0109] [6.0 SETK] **Sociolinguistika shqipe**
- [CM252] [6.0 SETK] **Studime bashkëkohore shqipe**
- [EM564] [6.0 SETK] **Gjuhësi krahasimtare historike**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e përgjithshme**

Semestri 4

- [MCAS4010] [30.0 SETK] **Punimi i magjistraturës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Civilizimi shqiptar**

Përmes kësaj lënde zbulohen aspektet më relevante të kulturës, civilizimit kombëtar dhe shoqërisë bashkëkohore shqiptare. Lënda ofron dije themelore përmes disa sferave kyçe, duke e analizuar në mënyrë të gjithanshme letërsinë dhe kulturën në një perspektivë evropiane.

- **Etnolinguistika**

Kjo lëndë përfshin marrëdhëniet në mes të gjuhëve të popujve, ndikimet e ndërsjella të faktorëve gjuhësorë dhe etnikë në zhvillimin e gjuhës dhe të veçorive të ndryshme të stereotipave. Etnolinguistika ka ndikim në gjuhë, kulturë, onomastikë, letërsi etj.

- **Dimensioni ballkanik i folklorit shqiptar**

Është një materie mjaft e pasur dhe e thuktë nga folklori shqiptar dhe ai ballkanik, përmes së cilës veçohet me vlerat e mëdha të kulturës shpirtërore, të trashëguara nga gjeniu popullor, vlera këto që dëshmojnë për bukurinë e krijimtarisë popullore dhe me fuqinë krijuese poetike të krijuesve anonimë, për aftësitë krijuese të tyre në sferat e artit, i cili pasqyron qartë e bukur të kaluarën historike të popullit shqiptar dhe popujve të Ballkanit.

- **Fonetika eksperimentale**

Lënda përfshin historinë e fonetikës, të fonetikës eksperimentale, komponentët fonologjikë, fonemat, formimin e tyre dhe mënyrën e ndarjes në grupe e nëngrupe, rolin e elementeve fonologjike, dallimin midis gjuhës së vjetër shqipe dhe gjuhës së sotme standarde.

- **Analiza e tekstit letrar**

Tekstet letrare dhe përfaqësuesit e tyre prezantohen gjithanshëm, duke u nisur nga analizat e temave dhe motiveve të ndryshme, çështjeve të stilistikës dhe mënyrës së interpretimit të tekstit letrar.

- **Letërsia moderne shqipe**

Karakteristikat kryesore të modernizmit shqiptar janë tendencat pozitive të modernistëve, kërkesat e tyre në letërsi, gjendja sociale-politike dhe letërsia, motivet dhe subjektet mbisunduese në veprat e tyre, ideja universale, filozofia jetësore, parashikimi i vështirësive, optimizmi i madh jetësor, temat e ngjarjeve historike.

- **Metodologjia e hulumtimit**

Materiali i këtij programi ka të bëjë me format dhe metodat më të reja të metodologjisë bashkëkohore për studimin e lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe. Në fakt këtu përfshihen metodat, format, teknikat, organizimi i punës individuale hulumtuese shkencore me karakteristikat specifike të saj.

- **Sociolinguistika shqipe**

Lënda e përfshinë pjesën praktike dhe teorike që ka për qëllim konceptet themelore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet gjuhësore dhe shoqërore, përkatësisht me mënyrën në të cilën e shfrytëzojmë gjuhën në kontekste të ndryshme shoqërore, si dhe në shkaqet themelore të varianteve gjuhësore. Funksioni i gjuhës në shoqëri,

marrëdhëniet midis gjuhës dhe kulturës; Stratifikimi horizontal dhe vertikal i gjuhës; diferencimi; politika gjuhësore; normimi i gjuhës standarde.

- **Studime bashkëkohore shqipe**

Qëllimi i lëndës: •Studentët do të fitojnë njohuri të reja nga letërsia bashkëkohore shqiptare. •Do të pajisen me dituri për vlerat artistike letrare. •Do të fitojnë njohuri për një qasje më të detajuar ndaj analizave dhe interpretimeve të romaneve të zgjedhura nga romancierët më të rëndësishëm të shekullit të 20-të. •Do të fitojnë njohuri në fushën e letërsisë bashkëkohore shqiptare, metodologjisë dhe studimit të vlerave të larta nga kjo fushë. •Do të përgatiten për krijimin e punimit kërkimor duke i aplikuar njohuritë teorike në veprat e caktuara të letërsisë të kësaj periudhe. •Do të njohtohen me sfidat drejt qasjes ndaj një teksti hermetik.

- **Gjuhësi krahasimtare historike**

Qëllimi i lëndës: Gjuhësia krahasimtare historike, është studim shkencor i ndryshimit të gjuhës me kalimin e kohës. Qëllimet kryesore të gjuhësisë historike përfshijnë: -përshkrimin dhe llogaritjen për ndryshimet e vërejtura në gjuhë të veçanta; -rindërtimin e parahistorisë së gjuhëve dhe përcaktimin e lidhjes së tyre, duke i grupuar ato në familje gjuhësore (gjuhësia krahasuese); -zhvillimin e teorive të përgjithshme për mënyrën se si dhe pse ndryshon gjuha; -përshkrimin e historisë së bashkësive të të folurit; -studimin e historisë së fjalëve, pra etimologjinë.

- **Punimi i magjistraturës**

Studentët futen në lëndën e studimit dhe përqendrohen në zgjidhjen e problemit hulumtues për tezën; mbledhin materialin për tezën, bëjnë përzgjedhjen, interpretimin e materialeve teorike dhe empirike nëpërmjet metodave të përparuara cilësore dhe sasimore.

Lëndë zgjedhore

- **Dialektologji - Mikrosistemi në kontakt**

Temat kryesore të kësaj lënde janë: zhvillimi historik i dialekteve, klasifikimi i dialekteve dhe nëndialekteve në të gjitha trojet shqiptare, ndërrimet dialektore nga aspekti fonetik, morfologjik, sintaksor leksikor dhe frazeologjik; transkriptimi dialektologjik.

- **Gjuhët në kontakt**

Qëllimi i lëndës: Të njihemi me bazën e gjuhëve ballkanike, të cilat në strukturën e tyre kanë karakteristika të kontaktit me gjuhët e tjera. Lidhja e të gjitha gjuhëve të Ballkanit është për shkak të kontakteve, d.m.th. ndikimin e ndërsjellë dhe që të gjithë të bëjnë një bashkim gjuhësor ballkanik. Lidhja farefisnore e gjuhëve nga kontakti ka dy lloje, me huazime (p.sh. rreth 2000 fjalë në maqedonisht janë të huazuara nga turqishtja dhe rreth një mijë nga greqishtja), dhe nëpërmjet mësimi të papërsosur të gjuhës, kur më tepër është pranuar struktura e gjuhës, kurse fjalorit i është dhënë më pak rëndësi (për shembull humbja e paskajores, rasat...). Njohja me kufijtë e sotëm gjuhësorë, politikë dhe sociolinguistikë të të gjitha gjuhëve në Ballkan që nuk përkojnë me realitetin real gjuhësor. Njohja me dygjuhësinë (dygjuhësinë kolektive, individuale dhe funksionale) te popujt ballkanikë. Përmes kontakteve, le të njihemi me huazimet gjuhësore dhe dhënien e tyre në një gjuhë tjetër.

- **Stilistika dhe pragmatika**

Qëllimi i lëndës: Gjuhësia, stilistika dhe pragmatika tradicionale e gjuhës shqipe është e lidhur ngushtë me lëndën e shkencave të tjera gjuhësore. Qëllimi i këtij programi është të studiojë lëndën e Stilistikës dhe Pragmatikës nga dy aspekte kryesore. Njëra është nga fusha e gjuhës, e dyta është nga fusha e letërsisë. Një qëllim i dytë është që studentët të dallojnë marrëdhënien midis jetës së përbashkët në krahasim me gjuhësinë e përbashkët. Këtu, ndryshimi standard dhe individ si person që flet janë në diskutim. Qëllimi i tretë është gjithashtu i rëndësishëm, po aq sa është i rëndësishëm është zhvillimi i mundësisë aktuale dhe zhvillimi i gjuhës si mjet shoqëror. Nivelet e analizës, relacioni, gjuha dhe diasistemet dialektike në shoqëri dhe në thelb në shoqërinë tonë. Në të gjithë këtë është e rëndësishme si synim që studentët të bëjnë diferencimin në mjedisin social, planifikimin gjuhësor, dallimin ndërmjet diglosisë dhe dygjuhësisë. Si një objektiv më vete, studentët duhet të krahasojnë atë që është më e rëndësishme; për të diferencuar gjuhët në rajonin e Ballkanit.

- **Hyrje në gjuhësi të përgjithshme**

Qëllimet e lëndës: -Studentët të njihen me historinë e gjuhësisë si sfidë shkencore për përshkrimin dhe sqarimin e shkathtësive njerëzore për gjuhën; -Të shqyrtohen fillimet e gjuhësisë nga civilizimet e vjetra, deri te gjuhët klasike liturgjike, si dhe ata të gramatikës sanskrite të Paninit (shekulli i 4 p.e.s.), ose me zhvillimin e logjikës dhe retorikës te grekët. Në fillim të shekullit 4 p.e.s., do të shqyrtohen edhe prurjet e civilizimeve të ndryshme, të cilët zhvilluan traditat

e veta gramatikore, si: gramatikat kineze, arabe dhe hebreje, të cilët janë zhvilluar gjatë mesjetës; -Filimet e gjuhësisë moderne, e cila filloi të zhvillohet në shekullin 18, me tendencë të arrijë kohën e artë të filologjisë në shekullin 19. -Të njihen me shkollat gjuhësore, të cilët janë paraqitur në gjysmën e dytë të shekullit 20, e cila është e shenjëzuar me shkollën strukturale bazuar në punën e Ferdinand de Saussure në Evropë si dhe të Eduard Sapir dhe Leonard Blumfeldit nga SHBA. Në vitin 1960 ka pasur zhvillim të hovshëm në shumë sfera të gjuhësisë, si p.sh. Të gramatikës gjenerative të Noam Chomsky, sociolinguistikën e Viljam Labovit si dhe psiholinguistikën bashkëkohore.

- **Onomastikë**

Qëllimi i lëndës: Të njihen me konceptin e onomastikës në gjuhën shqipe, që synon studimin e emrave të vendeve dhe të emrave të përveçëm. Studentët duhet të mësojnë për termat toponomastik dhe antroponomastik. Njohja me bazat e onomastikës dhe marrëdhëniet e saj me disiplina të tjera gjuhësore dhe jogjuhësore. Të aftësojë studentët për kërkime onomastike

- **Teoria e intertekstualitetit**

Objektivat e programit mësimor: 1. Krahasimet e një teksti me një tekst tjetër. 2. Teknika e gjetjes së ngjashmërive dhe dallimeve të një teksti me një tjetër. 3. Kuadri ndërtekstual i krahasimit të gjuhëve dhe teksteve. 4. Teoria e citimit të tekstit. 5. Dialogëzmi i teksteve.

- **Fjalëformimi në gjuhën shqipe**

Qëllimi i lëndës: Përvetësimi i lëndës dhe aftësimi i studentëve për ta zbatuar gjuhën në aspektin morfologjik (e fjalëformimit) edhe praktikisht. - të përdorë drejt dhe saktë trajtat e ndryshme të fjalëve në raport me kuptimin apo nuancën kuptimore, në bazë të paradigmave që ato marrin gjatë përdorimit në trajta të ndryshme; - të identifikojë pjesët e ligjëratës sipas funksionit të tyre; - të dallojë dhe interpretojë format analitike dhe sintetike të fjalëve të shqipes; - të interpretojë kuptimisht paradigmën fjalëformuese dhe trajtëformuese; - të identifikojë llojet e krijimit të fjalëve të reja në gjuhën shqipe, si: të prejardhjes, përbërjes, përngjitjes, konversionit, nyjëzimit.

- **Semantika**

Qëllimi i lëndës: Lënda e Semantikës ka për qëllim që studentët: -Të dinë se shenjuesit-fjalët dhe frazat çfarë synojnë në realitet; -Të dinë kuptimin e fjalëve në zgjedhjen e fjalëve ose konotacionit; -Të dinë për frazeologjizmat e gjuhës shqipe; -Të aftësohen, të identifikojnë, të kuptojnë dhe të zbatojnë konceptet dhe teoritë nga fusha e semilogjisë; -Të zhvillojnë aftësi komunikimi dhe transmetimit të dijes së tyre; -Të aftësohen për punë kërkimore-hulumtuese individuale e grupe.

- **Studime nga proza bashkëkohore shqipe**

Qëllimi i lëndës: Qëllimet e lëndës Studime nga proza bashkëkohore shqipe janë: 1. Trajnim për njohjen dhe respektimin e rasteve kulturore e shoqërore në të cilat zhvillohet letërsia bashkëkohore shqipe. 2. Marrja e njohurive për zhvillimin e letërsisë shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore e deri më sot. 3. Zhvillimi i aftësive të menduarit sintetik-analitik dhe kritik-krijues nëpërmjet punës në tekste të veçanta të letërsisë bashkëkohore shqipe. 4. Lidhja e njohurive nga disiplina të tjera letrare nëpërmjet përdorimit të terminologjisë letrare-teorike të adoptuar, e cila zhvillon dhe nxit aftësinë e studimit dhe përcjelljes së letërsisë shqipe të kësaj periudhe në kuadrin e letërsive ballkanike dhe evropiane.

- **Studime nga poezia bashkëkohore shqipe**

Qëllimi i lëndës: •Studentët do të fitojnë njohuri të reja nga letërsia bashkëkohore shqiptare. •Do të pajisen me dituri për vlerat artistike letrare. •Do të fitojnë njohuri për një qasje më të detajuar ndaj analizave dhe interpretimeve të romaneve të zgjedhura nga romancierët më të rëndësishëm të shekullit të 20-të. •Do të fitojnë njohuri në fushën e letërsisë bashkëkohore shqiptare, metodologjisë dhe studimit të vlerave të larta nga kjo fushë, në veçanti të poezisë. •Do të përgatiten për krijimin e punimit kërkimor duke i aplikuar njohuritë teorike në veprat e caktuara të letërsisë të kësaj periudhe. •Do të njoftohen me sfidat drejt qasjes ndaj analizës teorike të poezive. •Të fitojnë njohuri nga autorët bashkëkohor siç janë: Dritëro Agolli, Ismail Kadareja, Fatos Arapi, Esat Mekuli, Azem Shkreli, Ali Podrimja, etj.

- **Letërsi krahasimtare**

Qëllimi i lëndës: Lënda është krijuar që t'i përgatisë studentët për punë hulumtuese – shkencore në një fushë specifike të studimeve letrare. Studentët do të kenë mundësinë: të fitojnë informacione dhe të demonstrojnë njohuri për letërsinë e shkruar në vende të ndryshme e në periudha të ndryshme historiko – letrare; Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike – analitike e krahasimtare; Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko – letrare

